Preportr NUMËR 10 GAZETË PERIODIKE NËNTOR 2014 Botim i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese (QKGH). **Gazeta redaktohet nga:** Florie Xhemajli, Lorik Bajrami; **Fotograf:** Lorik Bajrami; **Reporterë:** Besa Kalaja; Besnik Boletini; Leonida Molliqaj; Kosovare Lalinovci; Qendrim Bunjaku. **Telefoni:** 038 248 506. **E-mail:** office@preportr.com. **www.preportr.com**



# PARTIA E PUNËS

## Fizionomia e patronazhit politik në Kosovë

Besnik Boletini dhe Besa Kalaja

## Fizionomia e patronazhit politik në Kosovë

# Partia e punës

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese – Preportr, ka gjetur se 250 zyrtarë të lartë publik me prapavijë të qartë partiake kanë qenë ose janë të punësuar në pozita të larta vendimmarrëse në institucionet publike. Të dhënat e hulumtuara nga Preportr, tregojnë se patronazhi politik ka shtrirje të gjerë, ka depërtuar në të gjitha institucionet dhe ka prekur të gjitha pozitat e larta publike. Në këtë aspekt prinë PDK, e pasuar nga LDK, dhe AAK, si dhe disa parti më të vogla. Indeksi i patronazhit të Kosovës, renditet ndër më të lartët në Evropë

BESNIK BOLETINI DHE BESA KALAJA

Është kohë kur ndërrimi i pushtetit po duket në horizont. Partitë që do ta formojnë qeverinë e re janë duke ëndërruar për privilegjet e ardhshme. Në ambientin politik kosovar ardhja në pushtet paraqet rastin e artë për konsolidim të partive politike, grupeve e individëve brenda tyre. Kjo duket të jetë edhe mënyra e vetme për mbijetesë, posaçërisht të partive që për vite me radhë nuk kanë qenë pjesë e pushtetit qendror.

Në një vend ku sektori publik është punëdhënësi më i madh me rreth 84 mijë kontribuues dhe ku qeveria e vendi ka rol thelbësor në ekonomi, kontrolli i frerëve të qeverisë paraqet karrem shumë të vlefshëm për partitë politike. Mundësitë e punësimit nëpër institucione shtetërore dhe të shpërndarjes së të mirave publike, sipas rregullit të pashkruar, përdoren për shpërblime të anëtarëve dhe militantëve politik, por edhe të bizneseve të lidhura me politikën.

Patronazhi politik - apo politizimi i institucioneve publike përmes punësimit të anëtarëve dhe militantëve partiak në pozita të larta publike - ka qenë dhe vazhdon të jetë një rregull i pushtetit politik në Kosovë. Shtrirja dhe konsolidimi i patronazhit politik bëhet kryesisht për qëllime të dyfishta: shpërblim dhe kontroll. Përmes kësaj qasjeje, partitë politike kanë arritur t'i konsolidojnë organizatat e tyre, t'i forcojnë bizneset dhe grupet e caktuara ekonomike dhe të interesit, por edhe t'i mbajnë lidhjet me votuesit e tyre. Kjo, kryesisht në dëm të konkurrencës së drejtë, të paanshme dhe të profesionalizmit gjatë procesit të rekrutimit të resurseve humane për administratën dhe institucionet e reja publike të vendit.

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr, ka ndërmarrë këtë hulumtim me qëllim të sigurimit të të dhënave empirike për sa i përket shtrirjes së patronazhit politik në institucione publike. Të dhënat e siguruara tregojnë se punësimi i individëve që kanë lidhje me ndonjë parti politike është i lartë, i shtrirë nëpër të gjitha institucionet publike si dhe prekë të gjitha pozitat në hierarkinë vendimmarrëse të institucioneve. Në kuadër të të gjeturave dëshmohet se vëllimi i punësimeve në institucione publike i individëve me përkatësi partiake është në proporcion të drejtë me fuqinë që partia apo koalicioni qeverisës ka në pushtetin qendror. Hulumtimi vërteton se trendi i politizimit të institucioneve publike brenda viteve 2010-2014 ka shënuar rritje konstante, me një rënie të lehtë në vitin 2014.

Një studim mbi patronazhin politik i realizuar nga Instituti D4D, ka nxjerrë se indeksi i patronazhit në Kosovë është 0,928, vlerë kjo e cila rendit më lartë se të gjitha 15 shtetet evropiane të marra në shqyrtim dhe shumë më e lartë se mesatarja prej 0,34 për këto shtete.

**FIZIONOMIA E PATRONAZHIT POLITIK**

Hulumtimi i realizuar nga Preportr, ka ardhur në disa përfundime për sa i përket patronazhit politik.

E para, të dhënat e dala nga hulumtimi tregojnë se institucionet publike, posaçërisht pozitat me fuqi vendimmarrëse, janë të politizuara në masë të lartë. Hulumtimi i Preportr, i cili është i shtrirë brenda viteve 2010-2014 ka gjetur se 250 zyrtarë të lartë publik që janë punësuar nëpër pozita vendimmarrëse në institucione shtetërore, kanë qenë dhe janë anëtarë të partive politike. Nga ky numër, sot ende janë duke punuar 185 zyrtarë të lartë publik.

E dyta, të gjeturat kanë treguar se patronazhi politik ka shtrirje gjithëpërfshirëse si në aspektin horizontal - i pranishëm nëpër të gjitha institu-

**TË DHËNAT E PËRGJITHSHME RRETH PATRONAZHIT POLITIK:**

- **250 ZYRTARË TË LARTË PUBLIK QË JANË PUNËSUAR NËPËR POZITA TË LARTA NË INSTITUCIONE PUBLIKE, JANË NJËKOHËSISHT EDHE ANËTARË/MILITANTË TË PARTIVE POLITIKE.**
- **SOT, NË KËTO POZITA ENDE JANË DUKE PUNUAR 185 ZYRTARË TË LARTË PUBLIK.**

## Metodologjia:

Ky hulumtim i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr, ka për qëllim të tregojë nivelin dhe shtrirjen e patronazhit politik - politizimin e institucioneve publike nga anëtarë dhe militantë të partive politike. Në fokus të hulumtimit ka qenë vetëm niveli i pozitave të larta publike - ashtu siç janë të përcaktuara me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Hulumtimi nuk ka përfshirë zyrtarë të tjerë publik të cilët nuk janë të obliguar që ta deklarojnë pasurinë. Preportr, ka kontrolluar regjistrat e deklarimit të pasurisë të 2 mijë e 132 zyrtarëve të lartë publik, të cilët janë punësuar përmes konkurseve. Në këtë shifër nuk përfshihet kategoria e gjykatësve dhe prokurorëve. Nga ky numër janë gjetur të dhëna faktike se 250 zyrtarë të lartë publik kanë lidhje me partitë politike.

Kriteret për ta përcaktuar përkatësinë partiake të një zyrtari të lartë publik me një parti politike kanë qenë që: a) zyrtari i lartë publik të ketë konkurruar në zgjedhje lokale dhe parlamentare për ndonjë subjekt politik; b) zyrtari të ketë rezultuar se ka qenë ose është anëtar i organeve të partive politike në struktura qendrore apo të degëve nëpër komuna, apo që; c) zyrtarët të kenë pasur poste politike në të kaluarën, si p.sh këshilltarët politik, e që pas një kohe kanë marrë pozita të larta publike përmes konkurseve.

Për të arritur në këtë përfundim, pra të konstatimit të lidhjes partiake të një zyrtari të lartë publik me një parti politike, Preportr, ka krahasuar emrat e 250 zyrtarëve me: a) listat zgjedhore komunale dhe nacionale të vitit 2007; b) listat zgjedhore nacionale të vitit 2010; c) listat zgjedhore lokale të vitit 2013; d) në disa raste janë shfrytëzuar edhe listat zgjedhore nacionale të vitit 2014, për të vërtetuar lidhjen e zyrtarit me partinë politike dhe; e) informacione zyrtare të marra nga faqet elektronike të partive politike, përkitazi me anëtarët e këshillit drejtues dhe të degëve të partive politike.

Preportr, ka hulumtuar punësimet e zyrtarëve që kanë lidhje me partitë politike që nga viti 1999. Por, këtu duhet sqaruar se të dhënat e siguruara për lidhjet partiake të 250 zyrtarëve të lartë publik kanë pikë referente vitin 2010, kur edhe ka filluar publikimi i regjistrave të deklarimit të pasurisë nga Agjencia kundër Korrupsionit. Pra, numri total prej 250 zyrtarëve të lartë publik me prapavijë partiake që janë gjetur në këtë hulumtim, vlen vetëm për zyrtarët që i kanë marrë postet nga viti 1999 dhe të cilët kanë vazhduar të punojnë të paktën deri në vitin 2010.

cionet (qendrore dhe lokale) - ashtu edhe në atë vertikal - prekë shumë pozita vendimmarrëse në kuadër të hierarkisë së institucioneve publike.

E treta, ndikimi i partive politike për sa i përket punësimit të anëtarëve dhe militantëve të tyre nëpër institucione publike reflekton plotësisht fuqinë e partive përkatëse në nivel qendror. Nga të dhënat e hulumtuara tregohet se nga 250 zyrtarë të lartë publik që Preportr, ka arritur t'i identifikojë si persona me prapavijë të qartë partiake dhe të cilët mbajnë pozita të larta në institucione publike, PDK prinë me 120 sosh, e pasuar nga LDK me 72, AAK me 25, AKR me 12, LDD me 9, të pasuara nga partitë e tjera më të vogla. (Shih tabelën me emra dhe pozita në vazhdim të gazetës)

## Punësimi i zyrtarëve të lartë publik me prapavijë të qartë partiake i ndarë sipas viteve:

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1999** 1 nga AAK, 1 nga LDK | **2002** 2 nga LDK, 1 nga PDK | **2003** 2 nga LDK | **2004** 1 nga PDK, 1 nga AAK |
| **2005** 3 nga LDK, 2 nga PDK, 1 nga AAK, 1 nga LDD | **2006** 1 nga PDK, 1 nga LDD | **2007** 2 nga LDK, 2 nga PDK | **2008** 21 nga PDK, 8 nga LDK, 2 nga AAK, 1 nga LDD, 1 nga ORA, 1 nga AKR |
| **2009** 8 nga PDK, 16 nga LDK, 1 nga AAK, 1 nga AKR, 1 nga Partia Demokratike Turke, 1 nga PSHDK | **2010** 17 nga PDK, 14 nga LDK, 5 nga AAK, 2 nga LDD, 1 nga ORA, 1 nga PD | **2011** 21 nga PDK, 10 nga LDK, 5 nga AAK, 2 nga AKR, 1 nga LDD, 1 nga ORA, 1 nga VV, | **2012** 25 nga PDK, 6 nga LDK, 7 nga AKR, 5 nga AAK, 2 nga NISMA, 2 nga ORA, 1 nga LDD, 1 me PD |
| **2013** 10 nga PDK, 3 nga AAK, 2 nga LDK, 2 nga AKR, 1 nga PD, 1 nga iniciativa e pavarur serbe | **2014** 2 nga PDK | | |

## Shtrirja e patronazhit politik sipas fuqisë së partive politike:

**Nga numri total prej 250 zyrtarëve të lartë që janë gjetur se kanë lidhje politike me parti politike:**

- 120 vijnë nga PDK;
- 72 nga LDK;
- 25 nga AAK;
- 12 nga AKR,
- 9 nga LDD;
- 5 nga ish-partia ORA;
- 3 nga PD;
- 1 nga PSHDK,
- 1 nga NISMA,
- 1 nga Partia Demokratike Turke,
- 1 zyrtar ka qenë në parti tjetër, kurse në zgjedhjet e fundit ka konkurruar me Lëvizja Vetëvendosje!

E katërta, hulumtimi ka treguar se trendi i punësimeve të individëve me përkatësi partiake në pozita të larta publike nga viti 2010, ka shënuar rritje konstante, me një rënie të lehtë në vitin 2014.

### PATRONAZHI POLITIK, NDARJA SIPAS INSTITUCIONEVE

Në sektorin e shërbimit civil në administratën e Kosovës pozita më e lartë është ajo e sekretarit të përgjithshëm. Kapja e pozitës së sekretarit të përgjithshëm konsiderohet si njëri nga mjetet kryesore për shtrirjen e patronazhit politik, marrë parasysh kompetencat e larta të tij në aspektin e punësimeve dhe largimeve nga puna të stafit të ministrive.

Preportr, ka arritur të identifikojë nëntë (9) sekretarë të përgjithshëm me prapavijë të qartë partiake. Nga ky numër, aktualisht këto pozita i ushtrojnë katër prej tyre dhe të gjithë kanë lidhje me PDK-në. Zgjedhja e sekretarit të përgjithshëm në baza politike, sipas studimit të D4D-së, hap rrugë për një proces i cili krijon mundësi të shumëfishimit të vetvetes pasi që përmes kësaj pozite mund të pasojnë emërimet në baza partiake të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët, duke u shtrirë kështu patronazhi politik në institucionet shtetërore.

Konstatimi i lartpërmendur mund të vërehet më së miri nga të dhënat e siguruara nga hulumtimi i Preportr. Të gjeturat tregojnë se nga 250 zyrtarët e lartë publik, që janë identifikuar me prapavijë të qartë partiake, 117 punojnë nëpër ministri dhe janë të pozicionuar në hierarki të ndryshme, përfshirë këtu: 65 drejtorë nëpër ministri të ndryshme, 9 kryeshefa , e deri tek pozita si ato të kryeinspektorëve dhe auditorëve të brendshëm.

Nga 117 zyrtarë në fjalë, 85 prej tyre janë duke punuar ende në pozitat përkatëse, përderisa pjesa tjetër janë ndërruar. Ndërrimet e këtyre zyrtarëve kanë ndodhur edhe për shkak të ndërrimit të ministrave dhe sekretarëve të përgjithshëm të cilët i kanë takuar ndonjë subjekti tjetër politik apo edhe të njëjtit subjekt.

Preportr, ka hulumtuar edhe zyrtarët e rinj që zëvendësuan ata paraprakë në pozita të njëjta dhe në ato raste që është arritur të vërtetohen është vërejtur se edhe disa nga ardhjet e reja nëpër këto pozita kanë prapavijë partiake. Nga një mostër prej 26 zyrtarëve që kanë zëvendësuar ata paraprakë, gjashtë (6) prej tyre kanë lidhje me partitë politike. Ndër ta, pesë (5) kanë lidhje me PDK-në, ndërsa një (1) me LDK-në.

Ka raste kur departamente të caktuara janë mbyllur pas largimit të drejtorit të departamentit, dhe të njëjtit janë sistemuar në institucione tjera publike. Një rast i tillë ka ndodhur me drejtorin e Departamentit për Politika të Diasporës, i cili pas mbylljes së departamentit është punësuar në Ambasadën e Kosovës në Zvicër si Ministër Këshilltar. Ky fakt dëshmon për sistemimin e zyrtarëve me lidhje politike nëpër institucione publike.

Në Zyrën e Kryeministrit, edhe pse pjesa më e madhe e stafit përbëhet nga ai politik, në disa pozita të larta që janë jopolitike janë të punësuar katër (4) zyrtarë të lartë që kanë lidhje direkte me partitë politike. Këta zyrtarë vazhdojnë të punojnë ende në këto pozita.

Duke marrë si pikë referente vitin 2010, rezultatet e hulumtimit tregojnë se ka një trend të rritjes (sidomos në tri

## Shtrirja horizontale dhe vertikale e patronazhit politik:

**Nga numri total prej 250 zyrtarëve të lartë që janë gjetur në hulumtim dhe që kanë lidhje partiake, 117 punojnë nëpër ministri. Nga ta:**

- 65 janë drejtorë;
- 9 sekretarë të përgjithshëm;
- 9 kryeshefa;
- 8 ambasadorë;
- 3 udhëheqës të divizioneve;
- 3 zv. drejtorë;
- 2 menaxherë;
- 3 konsullë;
- 2 sekretarë të parë në Ambasada (Japoni - Shkup);
- 2 koordinatorë;
- 2 kryeinspektorë;
- 1 sekretar i përgjithshëm në UPZ;
- 1 auditor i brendshëm;
- 1 kryetar bordi nacional - MSH;
- 1 shef i kabinetit të Diabetologjisë - MSH;
- 1 z.v. konsull;
- 1 zyrtar ligjor;
- 1 zyrtar kryesor financiar;
- 1 zyrtar i prokurimit dhe;
- 1 zyrtar për patent shofer.

28 NGA PDK;
24 NGA LDK;
7 NGA AAK;
4 NGA LDD;
1 NGA AKR;
1 NGA NISMA

6 NGA PDK;
2 NGA LDK;
(NUK JANË MË NË KËTË POZITË)
1 NGA NISMA.

> VAZHDON NË FAQEN 10

### REFLEKTIMI I FUQISË SË PARTIVE POLITIKE NË PUNËSIMIN E INDIVIDËVE NËPËR POZITA TË NDRYSHME NË MINISTRI:

**117 zyrtarët e lartë publik që punojnë nëpër ministri, i përkasin këtyre partive politike;**

- 54 vijnë nga PDK;
- 37 nga LDK;
- 9 nga AAK;
- 7 nga LDD;
- 4 nga AKR;
- 2 nga ish partia ORA;
- 2 nga PD;
- 2 nga NISMA

### PATRONAZHI POLITIK NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT:

**4 zyrtarë të lartë kanë lidhje direkte me politikën;**

- 2 drejtorë;
- 1 koordinator, dhe;
- 1 kryeshef.

**2 prej tyre janë të PDK-së, 1 i LDK-së dhe 1 nga Partia Demokratike Turke.**

## Trendi i punësimeve si dhe vazhdimësia e ushtrimit të funksionit gjatë viteve 2010-2014, të 250 zyrtarëve të lartë publik me përkatësi partiake:

**2010** - 136
**2011** - 170
**2012** - 216
**2013** - 218
**2014** - 185

(Numri prej 185 zyrtarëve të lartë publik me prapavijë partiake të evidentuar në vitin 2014, përfshinë vetëm ata zyrtarë që kanë marrë pozitat në vitet paraprake dhe që kanë vazhduar ushtrimin e funksionit deri në këtë vit. Ndërsa, të gjitha ata zyrtarë që mund të jenë punësuar gjatë vitit 2014, nuk janë përfshirë në hulumtim. Kjo sepse në kohën e realizimit të këtij hulumtimi, regjistrat e deklarimit të pasurisë nuk kanë qenë të publikuara nga AKK-ja, prej nga Preportr, do të mund të nxirrte të dhëna rreth punësimeve të reja gjatë vitit 2014. Kjo mungesë e të dhënave rreth punësimeve gjatë vitit 2014, mund të jetë një shpjegim i faktit rreth rënies së trendit të punësimeve politike gjatë këtij viti).

## Fizionomia e patronazhit politik në Kosovë

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr, ka siguruar të dhëna që dëshmojnë për shtrirjen e gjerë të patronazhit politik.
Hulumtimi tregon se që nga viti 2010 dhe deri më tani, rreth 250 zyrtarë të lartë publik të vendosur nëpër pozita vendimmarrëse nëpër institucione publike kanë qenë dhe janë anëtarë të partive politike.
Nga ky numër, sot ende janë të punësuar 185 zyrtarë të lartë publik, të cilët, kanë lidhje me partitë politike.

| | Të dhënat rreth zyrtarëve të lartë publik (vendi i punës dhe pozita) | | | | | | Përkatësia partiake e zyrtarëve të lartë publik |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kategoria | Institucioni | Emri dhe mbiemri | Pozita | Pershkrimi i pozites | Data e emerimit | Partia politike |
| 1 | Ministri | MTI | Agron Shurdhani | Drejtor | Drejtor i Institutit të Metrologjisë. | 3-Mar-08 | AAK |
| 2 | Ministri | MTI | Muhamet Rudari | Drejtor | Drejtor i departamentit të industrisë. Nga data 04.04.2013, mbanë pozitën e Udhëheqësit të Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim, në Agjencinë Kosovare për Standardizim në MTI. | 25-Mar-09 | LDK |
| 3 | Ministri | MTI | Shaban Halimi | Drejtor | Drejtor i Departamentit të Rezervave Shtetërore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë | 1-Apr-10 | LDK |
| 4 | Ministri | MTI | Sherif Sherifi | Drejtor | Drejtor i Administratës. Nga data 24.07.2013, është në pozitën si Udhëheqës i Sektorit të Mbikëqyrjes Inspektuese në Ferizaj dhe Rrethinë në Inspektoratin e Tregut në MTI | 31-Mar-10 | LDK |
| 5 | Ministri | MTI | Valdrin Lluka | Kryeshef | Kryeshef i Agjencisë për Promovimin e Investimeve | 27-Jul-11 | AKR-E15 |
| 6 | Ministri | MTI | Naser Grajçevci | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv i Agjencisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. (Ky agjencion është bashkuar me Agjencionin për Promovimin e Investimeve dhe tani quhet Agjencia për investime dhe përkrahje te ndërmarrjeve. Kryeshef i saj është Valdrin Lluka) | 2-Aug-08 | PDK |
| 7 | Ministri | MTI | Igballe Rexha -Jashari | U.d. Drejtor | U.D drejtoreshë e Departamentit të Tregtisë. Tash është drejtoreshë e Divizionit të Industrisë në Departamentin e Industrisë. | 15-Oct-08 | AAK |
| 8 | Ministri | MAP | Muhamet Latifi | Drejtor | Drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil | 28-Jul-10 | PDK |
| 9 | Ministri | MAP | Driart Elshani | Drejtor | Drejtor në departamentin e E-Qeverisjes dhe Proceseve Administrative | 7-Jun-11 | PDK |
| 10 | Ministri | MASHT | Agim Berdyna | Drejtor | Drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar. | 10-Sep-10 | LDK |
| 11 | Ministri | MASHT | Adlie Hamiti | Udhëheqës | Udhëheqëse e Kontrollit Intern - Qendra e Studentëve | 1-Jan-12 | LDK |
| 12 | Ministri | MASHT | Alush Istogu | Drejtor | Drejtori i Arsimit Parauniversitar. | 9-Apr-08 | PDK/IBQ |
| 13 | Ministri | MASHT | Avdulla Hoxha | Drejtor | Drejtor në qendrën e studentëve | 4-Feb-03 | LDK/PDK |
| 14 | Ministri | MASHT | Bekim Samadraxha | U.d Drejtor | u.d Drejtor i departamentit të arsimit të lartë | 3-Dec-12 | LDK |
| 15 | Ministri | MASHT | Driton Fetaj | Drejtor | Drejtor për Buxhet dhe Financa në Universitetin e Pejës | 1-Mar-13 | LDD |
| 16 | Ministri | MASHT | Ferit idrizi | Drejtor | Drejtor i Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar, integrim evropian dhe koordinim të politikave | 14-Feb-13 | PDK |
| 17 | Ministri | MASHT | Murteza Osdautaj | Drejtor | Drejtor i Departamentit për Shkencë dhe Teknologji | 1-Oct-07 | LDK |
| 18 | Ministri | MASHT | Nezir Çoçaj | Drejtor | Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës. | 15-Dec-10 | PDK |
| 19 | Ministri | MASHT | Xhavit Dakaj | Sekretar | Sekretar i përgjithshëm në MASHT. | 8-Jun-11 | PDK |
| 20 | Ministri | MBPZHR | Kadri Kadrijaj | Drejtor | Drejtor i inspektoratit të pyjeve | 22-Sep-10 | PDK |
| 21 | Ministri | MBPZHR | Kapllan Halimi | Sekretar | Sekretar i përgjithshëm në MBPZHR | 13-May-12 | PDK |
| 22 | Ministri | MBPZHR | Uran Ismaili | Koordinator | Koordinator në MBPZHR | 2011 | PDK |
| 23 | Ministri | MBPZHR | Muzafer Luma | Kryeshef | Ish-kryeshef i Agjencise Pyjore | 5-May-05 | LDK |
| 24 | Ministri | MDI | Shyhrete Gosalci | U.d Sekretar | U.d sekretare e pergjithshme | 31-Dec-12 | Nisma |
| 25 | Ministri | MD | Astrit Kolaj | Drejtor | Drejtor i departamentit për informim (Ka punuar deri më 31 gusht 2014. Aktualisht punon si menaxher i zyrës për komunikim publik në Prokurori të Shtetit) | 1-Oct-09 | LDK |
| 26 | Ministri | MD | Bajram Bujupi | zv.Drejtor | Zv.drejtor i Shërbimit Korrektues të Kosovës | 9-Mar-12 | PDK |
| 27 | Ministri | MD | Halil Bllaca | Drejtor | Drejtor i Administratës | 7-Feb-11 | LDK |
| 28 | Ministri | MD | Hamit Ademaj | Ish-Drejtor | Ish-drejtor i qendrës së paraburgimit në Prizren | 29-Oct-12 | PDK |
| 29 | Ministri | MD | Heset Loku | Drejtor | Drejtor i Qendrës Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan. | 1-Jul-12 | PDK |
| 30 | Ministri | MD | Luljeta Baraliu | Udhëheqës | Udhëheqëse financiare | 4-May-11 | LDK |
| 31 | Ministri | MD | Naim Maloku | Ish- Drejtor | Ish-drejtor i burgut për siguri të lartë në Podujevë | 2013 | AAK-AKR |
| 32 | Ministri | MD | Shefik Sylejmani | Drejtor | Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan. | 1-Jul-12 | PDK |
| 33 | Ministri | MD | Shemsi Hajrizi | zv.Drejtor | zv.Drejtor i Shërbimit Korrektues të Kosovës | 20-Nov-08 | LDK |
| 34 | Ministri | MD | Ylber Topalli | Kryeinspektor | Kryeinspektor i Shërbimit Korrektues të Kosovës | 2011 | PDK |
| 35 | Ministri | MD | Haki Maxharraj | Drejtor | Ish-drejtor i burgut të Dubraves | 1-Sep-08 | LDK |
| 36 | Ministri | MD | Florian Dushi | Sekretar | Ish-sekretar i përhershëm në MD | 3-Aug-09 | LDK |
| 37 | Ministri | MF | Bashkim Shala | Drejtor | Drejtor - Njësia e Auditimit të Brendshëm në ATK | 1-Jul-05 | LDK |
| 38 | Ministri | MF | Hamdi Hoxha | Menaxher | Menaxher i Zyres Regjionale - ATK | 2-Sep-10 | LDK |
| 39 | ministri | MF | Nita Korenica | Auditor | Auditore e brendëshme | 5-Jan-10 | LDD |
| 40 | Ministri | MF | Sakip Imeri | Drejtor | Drejtor i Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve në ATK. | 13-Jun-05 | LDK |
| 41 | Ministri | MF | Ukshin Rrecaj | Drejtor | Drejtor rajonal i ATK-së. | 1-Feb-10 | PDK |
| 42 | Ministri | MF | Isen Lipovica | Menaxher | Menaxher i Divizionit për Politika dhe Procedura në ATK | 1-Feb-10 | PDK |
| 43 | Ministri/Up | MASHT | Adem Sallauka | Sekretar | Sekretar i përgjithshëm në UPZ. | 1-Oct-10 | PDK |
| 44 | Ministri/Up | MASHT | Alberta Troni | Prodekan | Prodekane në Fakultetin e Artëve | 1-Oct-12 | LDK |
| 45 | Ministri/Up | MASHT | Afrim Loku | Prodekan | Prodekan në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. | 5-Nov-13 | AKR |
| 46 | Ministri/Up | MASHT | Agim Zogaj | Prodekan | Prodekan në Fakultetin Filozofik | 1-Oct-12 | PDK |
| 47 | Ministri/Up | MASHT | Behxhet Brajshori | Dekan | Dekan në UPZ | 1-Oct-11 | LDK |
| 48 | Ministri/Up | MASHT | Bujar Dugolli | Dekan | Dekan UP - Filozofik | 1-Oct-12 | PDK/AAK |
| 49 | Ministri/Up | MASHT | Bujar Pira | Dekan | Dekan - Fakulteti i Shkencave të Aplikuara | 20-Oct-12 | AKR-E15 |
| 50 | Ministri/Up | MASHT | Enver Hamiti | Dekan | Dekan - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike | 1-Oct-12 | Ora |
| 51 | Ministri/Up | MASHT | Ethem Çeku | Dekan | Dekan në Fakultetin e Edukimit. | 2012 | AAK |
| 52 | Ministri/Up | MASHT | Hakif Zeqiri | Dekan | Dekan - Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Mitorvicë | 1-Oct-12 | PDK |
| 53 | Ministri/Up | MASHT | Ibrahim Gashi | Ish- Rektor | Rektor | 1-Oct-12 | AKR |
| 54 | Ministri/Up | MASHT | Zeqir Veselaj | Prodekan | Prodekan në Faluktetin e Edukimit | 28-Dec-10 | AAK |
| 55 | Ministri/Up | MASHT | Haqif Mulliqi | Ish- Prodekan | Ka qenë, prodekan në Fakultetin e Artëve | 1-Oct-09 | PDK |
| 56 | Ministri/Up | MASHT | Haxhi Ferati | Ish-Prodekan | Ka qenë prodekan në Fakultetin Filozofik | 8-Nov-10 | AAK |
| 57 | Ministri/Up | MASHT | Mujë Rugova | Ish-Rektor | Ka qenë rektor i UP-së | 1-Sep-09 | PDK |
| 58 | Ministri/Up | MASHT | Mazllom Kumnova | Ish-Prorektor | Ka qenë prorektor në Fakultetin e Edukimit Gjakovë. | 1-Oct-09 | AAK |
| 59 | Ministri/Up | MASHT | Safet Merovci | Ish-Prodekan | Ka qenë prodekan në Fakultetin Ekonomik - UP | 1-Dec-11 | PDK |
| 60 | Ministri | MSFK | Haxhi Shala | Drejtor | Drejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane | 22-Oct-09 | PDK/NISMA |
| 61 | Ministri | MSFK | Imri Ilazi | Drejtor | Drejtor i Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve | 15-May-12 | NISMA |
| 62 | Ministri | MSFK | Zijadin Bajçinca | Drejtor | Drejtor i departamentit të logjistikës | 1-Oct-09 | PDK |
| 63 | Ministri | M.Infrastruktures | Shasivar Haxhijaj | Ish-Sekretar | Ish-sekretar i përgjithshëm në Ministrin e Infrastrukturës | 19-Sep-12 | PDK |

| | Vazhdimësia e ushtrimit të funksionit gjatë viteve 2010-2014 | | | | | Prejardhja e zyrtarit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Lidhja me partine | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | Komuna |
| Nga viti 2002 deri më 2007 ka qenë kryeshef i Komunës së Kaçanikut | ✓ | ✓ | | | | Kaçanik |
| Në një raport për komunen e Lipjanit, është cekur se është inspektor nga radhët e LDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Lipjan |
| Kandidat për asamble komunale në Dragash në vitin 2009 dhe deputet i Kuvendit të Kosovës nga LDK - 2004-2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Dragash |
| Asambleist nga LDK 2007-2013. Nenkryetar i degës së LDK-së në Viti | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Viti |
| Ka qenë kandidat për deputet në koalicionin për Kosovën e Re (nga grupi E15) | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Ka qenë kandidat për kryetar të Fushë Kosovës në zgjedhjet e vitit 2013, ka qenë asambleist në vitin 2002 në këtë komunë. | ✓ | ✓ | | | | Fushë Kosovë |
| Kandidate e AAK-së për deputete në Kuvendin e Kosovës - 2010 dhe asambleiste e AAK në KK Prishtinë - 2007 | ✓ | | | | | Prishtinë |
| Është kryetar i degës së PDK-së në Podujevë | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Podujevë |
| Ka qenë pjesë e grupit që kanë aderuar në PDK në vitin 2010. | | ✓ | ✓ | ✓ | | Prishtinë |
| Ka qenë kandidat për kryetar të Pejës në zgjedhjet lokale 2009. Anetar i kryesisë së LDK-së në Pejë (2013) | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Ka qenë asambleist në KK Podujevë (2007). | | | ✓ | ✓ | ✓ | Podujevë |
| Ka qenë drejtor i arsimit në KK Drenas dhe Kandidat për asamble komunale - Drenas nga Iniciativa Qytetare e Bashkuar. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Drenas |
| Asambleist në KK Ferizaj. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Asambleist KK Malishevë - 2009 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Malishevë |
| Kandidat për asamble komunale në KK Deçan. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Deçan |
| Asambleist në KK Vushtrri (PDK). Ka qenë edhe kryesues i Kuvendit Komunal. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Asambleist në KK Deçan në zgjedhjet lokale të vitit 2000. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Deçan |
| Kandidat për deputet nga PDK - 2014. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Kandidat për asamble KK Lipjan 2007. Udhëheqës i personelit në Komunën e Lipjanit deri më 2010. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Lipjan |
| Ka qenë kandidat për asambleist KK Deçan në vitin 2007 dhe vitin 2009. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Deçan |
| Anetar i këshillit drejtues të degës së PDK-së në Prishtinë. I aderuar në PDK në vitin 2007. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë kandidat për asamble në KK Prishtinë në vitin 2007 dhe 2013. Është anëtar i kryesisë së degës së PDK-së në Prishtinë. | | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Kandidat për deputet nga LDK, me 2004 dhe 2007. Asambleist në KK Kaçanik në dy mandate 2000 dhe 2005 | ✓ | | | | | Kaçanik |
| Kandidate për deputete në Kuvendin e Kosovës - 2014 | | | ✓ | ✓ | | Prishtinë |
| Është aktivist shumëvjeçar i LDK-së. Merr pjesë në organizime të fushatave dhe disa herë ka marrë pjesë në mbarëvajtjen e konferencave të LDK-së. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Klinë |
| Ka qenë kandidat për asamble - KK Prishtinë - 2007 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës nga LDK në zgjdhjet 2010. Nga viti 2000 deri në vitin 2006 ka qenë drejtor i Drejtorisë për Administratë KK Gjilan nga radhët e LDK-së. Keshilltar i ministrit të MPB-së Fatmir Rexhepi - 2006. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Ka qenë kandidat për asamble komunale KK Prizren - 2009. Është zgjedhur asambleist nga PDK në vitin 2000. | | | ✓ | ✓ | | Prizren |
| Kandidat për deputet nga PDK -2010. Kandidat për asamble KK Kaçanik, 2007 dhe 2009. Nenkryetar i KK Kaçanik. Drejtor i administratës KK Kaçanik - 2008. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Kaçanik |
| Asambleiste në KK Suharekë nga LDK me 2009 dhe 2013. Anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa në Kuvendin Komunal Therandë (LDK). | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Suharekë |
| Ka qenë deputet nga radhët e AAK. Këshilltar i ish-presidentit Behgjet Pacolli. Ka aderuar në AKR. Kandidat për deputet nga AKR - 2014. | | | | ✓ | | Pejë |
| Kandidat për asamble KK Viti - 2007. Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Vitisë 21 Jan 2008 (e ka marrë detyrën). | | | ✓ | ✓ | ✓ | Viti |
| Kandidat për asamble në KK Vushtrri - 2007. Zv. kryetar i Komunës së Vushtrrisë. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës - 2010. Asambleist në KK Ferizaj - 2007-2013. Kryetar i degës së PDK-së në Ferizaj - (tash nënkryetar). | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Kandidat per asamble KK Istog. Kryetar i nëndegës së LDK-së në Vrellë | ✓ | ✓ | ✓ | | | Istog |
| Është përfaqesues i LDK-së në KQZ. (që nga 05 tetor 2007) | ✓ | | | | | Prishtinë |
| Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë drejtor për ekonomi në KK Malishevë - 2002 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Malishevë |
| Ka qenë kandidate për asamble komunale në Mitrovicë. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Mitrovicë |
| Ka qenë kryetar i degës së LDK-së në Shterpcë. Asambleist nga LDK në KK Shterpcë - 2002 dhe 2005. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Shterpcë |
| Asambleist në KK Mitrovicë 2007-2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Mitrovicë |
| Anëtar i kryesisë së degës së PDK-së në Ferizaj. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Ka qenë kandidat për asamble komunale në Prizren në zgjedhjet e vitit 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Ka qenë kandidate e LDK-së për zgjedhjet parlamentare 2010. Gjithashtu ka qenë këshilltare e ministrit të kulturës Valton Beqiri në vitin 2010 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kryetar i degës së AKR-së në Kaçanik (2013). Ka fituar për asambleist në vitin 2007 nga radhët e AKR-së në Kaçanik. Ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet lokale - 2009 | | | | ✓ | ✓ | Kaçanik |
| Nënkryetar i Kryesisë së PDK-Dega në Prizren. Ishte kandidat (PDK) për asamble komunale në zgjedhjet lokale 2013. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Kandidat për deputet (2010). Zv.ministër i MSFK. Zv.ministër në MEF. Deputet në Kuvendin e Kosovës(LDK). Ministër në MKRS. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për deputet (2010). Ministër i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës. (AAK) Deputet ne Kuvendin e Kosoves 2007-2010 (AAK). | | | ✓ | ✓ | ✓ | Drenas |
| Kandidat për deputet me "Koalicionin për Kosovë të Re" nga grupi E15. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për asamble komunale - KK Prishtinë | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ish-ministër i Energjetikës dhe Minierave dhe ish-ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës 2010. Dy mandate ka qenë deputet nga radhët e AAK-së. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Kandidat për asamble KK Mitrovicë 2007. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Mitrovicë |
| Zv.Minister i MPJ nga AKR. Ka qenë nenkryetar i AKR-së në këtë periudhë kohore | | | ✓ | ✓ | ✓ | Drenas |
| Këshilltar i Ministrit Ethem Çeku në MMPH. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Klinë |
| Këshilltar i ministrit të MKRS Memli Krasniqi (2011-2012) | ✓ | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Kandidat per deputet nga AAK | ✓ | ✓ | ✓ | | | Prizren |
| Është raportuar se ka qenë i afërt me PDK-në. Është parë në aktivitete bashkë me kreun e PDK-së Hashim Thaçi. | ✓ | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Ish-deputet në Kuvendin e Kosovës 2004-2007. Anëtar i Keshillit të Përgjithshëm të AAK-së në Kuvendin e V-të Zgjedhor. Kandidat për deputet nga AAK në vitin 2001. Kandidat për deputet në vitin 2014. | ✓ | ✓ | ✓ | | | Gjakovë |
| Ish-Këshilltar i kryeministrit Bajram Rexhepit (2002-2004). Ish-anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së. Zv. Minister i financave në qeverinë e perkohshme 1999-2000. | | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Deputet i PDK-së pas largimit të Idriz Vehapit në vitin 2013, deputet nga NISMA në vitin 2014 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Prizren |
| Kandidat për deputet me 2014 nga NISMA. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Asambleist në KK Fushë Kosovë 2004-2009. Sekretar i degës së PDK-së në Fushë Kosovë. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Fushë Kosovë |
| Aktualisht këshilltar i ministrit të MKRS. Kandidat për kryetar të Istogut më 2013 dhe më 2010. Ka qenë kandidat për deputet me 2007 | | | ✓ | ✓ | | Istog |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 64 | Ministri | M.Infrastruktures | Lahudin Myrtaj | Ish-Drejtor | ish-drejtor i Drejtorisë së Rrugëve në Ministrinë e Infrastrukturës | 1-Jan-11 | PDK |
| 65 | Ministri | MKRS | Brikena Mulliqaj | Drejtor | Drejtoreshë e Departamentit për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politi-kave. | 11-Oct-11 | PDK |
| 66 | Ministri | MKRS | Burbuqe Bakija – Deva | U.d Drejtor | U.d Drejtor në Institutin Rajonal për Mbrojtje të Monumenteve | 20-Jun-13 | AAK |
| 67 | Ministri | MKRS | Feim Maliqaj | Drejtor | Drejtor i Departamentit të Administratës Qëndrore. | 11-Oct-11 | PDK |
| 68 | Ministri | MKRS | Florim Kryeziu | Udhëheqës | Udhëheqës i divizionit për infrastrukturë sportive | 3-Jan-13 | PDK |
| 69 | Ministri | MKRS | Feim Hoxha | Zyrtar | Zyrtar ligjor | 3-Jan-13 | PDK |
| 70 | Ministri | MKRS | Gani Mehmetaj | Drejtor | Drejtor i KosovaFilm | 1-May-03 | LDK |
| 71 | Ministri | MKRS | Iber Alaj | Drejtor | Drejtor i sportit | 16-Feb-09 | LDK |
| 72 | Ministri | MKRS | Ismail Kasumi | Drejtor | Drejtor i Shtëpisë së sportit të Kosovës | | LDK |
| 73 | Ministri | MKRS | Shkëmb Manaj | Drejtor | Drejtor | 10-Feb-09 | LDK |
| 74 | Ministri | MKRS | Veton Firzi | Sekretar | Sekretar i përgjithshëm - MKRS dhe U.d drejtor në MBPZHR | 25-May-11 | PDK |
| 75 | Ministri | MKRS | Salih Morina | Ish-Sekretar | Ish-sekretar i përgjithshëm në MKRS - 2008-2011 | 9-May-08 | LDK |
| 76 | Ministri | MMPH | Bedri Halimi | Kryeinspektor | Kryeinspektor | 17-Nov-08 | PDK |
| 77 | Ministri | MMPH | Ferki Fejza | Ish-U.d Krye-shef | Ish-u.d. kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Rrezatim dhe Siguri. | 21-Jun-11 | PDK |
| 78 | Ministri | MPMS | Dëfrim Rifaj | Drejtor | Drejtor i Departamentit të Punës dhe Punësimit | 7-Oct-08 | PDK |
| 79 | Ministri | MPMS | Gafurr Podvorica | Drejtor | Drejtor i Institutit për Politika Sociale | 10-Apr-09 | PDK |
| 80 | Ministri | MPB | Enver Hoti | Drejtor | Drejtor - Agjencia e Menaxhimit Emergjent | 13-Aug-12 | PDK |
| 81 | Ministri | MPB | Ilhami Gashi | Sekretar | Sekretar i përgjithshëm - MPB | 1-Aug-11 | PDK |
| 82 | Ministri | MPB | Miran Demiri | Koordinator | Koordinatorin e Qëndrës Operative Emergjente Rajonale | 14-Aug-12 | PDK |
| 83 | Ministri | MPB | Drita Hasani | Zyrtar | Zyrtare Kryesore Financiare | 21-Nov-06 | LDD |
| 84 | Ministri | MPJ | Agron Smakiqi | Sekretar | Sekretar i Parë në Ambasadën e Kosovës në Shkup | 15-Apr-10 | ORA |
| 85 | Ministri | MPJ | Artan Behrami | Drejtor | Drejtor i zyrës për Informim | 1-Mar-11 | PDK |
| 86 | Ministri | MPJ | Ahmet Shala | Ambasador | Ambasador i Kosovës në Japoni | 27-Nov-12 | PDK |
| 87 | Ministri | MPJ | Ali Kamberi | Konsull | Konsull i Ambasdës së Kosovës në Ankrara | 1-Nov-13 | PD |
| 88 | Ministri | MPJ | Arben Muhameti | zv. Konsull | zv/Konsull në Romë | 23-Nov-09 | PDK |
| 89 | Ministri | MPJ | Edon Cana | Konsull | Konsull në Strasburg | 25-Mar-12 | PDK |
| 90 | Ministri | MPJ | Mimoza Ahmetaj | Ambasador | Ambasadore e Kosovës në Bruksel | 1-Jun-12 | PDK |
| 91 | Ministri | MPJ | Rudina Bukoshi | Sekretar | Sekretare e parë në Ambasadën e Kosovës në Japoni. | 1-Oct-08 | LDK |
| 92 | Ministri | MPJ | Sabri Kiçmari | Ambasador | Ambasador i Kosovës në Austri dhe Australi | 7-Sep-09 | PDK |
| 93 | Ministri | MPJ | Shpend Kallaba | Ambasador | Ambasador i Kosoves në Bullgari | 16-Apr-12 | AKR |
| 94 | Ministri | MPJ | Ylber Hysa | Ambasador | Ambasador i Kosovës në Maqedoni | 27-Feb-12 | ORA |
| 95 | Ministri | MPJ | Muhamet Hamiti | Ish-Ambasa-dor | Ish-ambasador i Kosovës në Londër. | 25-Aug-09 | LDK |
| 96 | Ministri | MSH | Abdylatif Latifi | Drejtor | Drejtor i Spitalit Rajonal në Gjilan | 27-Jul-12 | PDK |
| 97 | Ministri | MSH | Afrim Dervishi | Kryeshef | Kryeshef i Departamentit të emergjencës dhe anestezionit në Spitalin Rajonal të Gjakovës | 2012 | AAK |
| 98 | Ministri | MSH | Basri Lenjani | Drejtor | Drejtor i qëndres emërgjente në QKUK | 1-Oct-05 | LDD/AAK |
| 99 | Ministri | MSH | Fazli Jetullahu | Kryeshef | Kryeshef | 1-Jan-05 | AAK |
| 100 | Ministri | MSH | Gëzim Devolli | Kryetar bordi | Kryetar i bordit nacional në spitalin rajonal në Pejë | 1-Jan-10 | LDK |
| 101 | Ministri | MSH | Haxhi Kamberi | Drejtor | Drejtor i spitalit Rajonal në Gjakovë. Ka qenë U.d sekretar permanent në MSH. | 3-Oct-12 | LDK |
| 102 | Ministri | MSH | Hyrije Fejza | Drejtor | Drejtoreshë në Institutin e Shëndetit Publik në Komunën e Mitrovicës | 1-Jan-02 | LDK |
| 103 | Ministri | MSH | Hatim Baxhaku | Kryeshef | Kryeshef i kirurgjisë në spitalin rajonal në Prizren (Ka punuar në këtë post deri më 28.02.2014) | 1-Jan-02 | LDK |
| 104 | Ministri | MSH | Ilaz Poroshtica | Kryeshef | Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë në Spitalin Rajonal të Gjilanit | 3-Oct-08 | AKR |
| 105 | Ministri | MSH | Imet Rrahmani | Kryeshef | Kryeshef i emergjencës në spitalin rajonal Gjilan | 1-Jan-08 | LDK |
| 106 | Ministri | MSH | Ismet Bardhoshi | Drejtor | Drejtor në Qëndren e Shëndetit Mendor në Gjakovë | 18-Mar-10 | AAK |
| 107 | Ministri | MSH | Luan Nagavci | U.d Drejtor | U.d drejtor i Institutit të Mjekësisë së Punës në Gjakovë | 28-Jan-13 | AAK |
| 108 | Ministri | MSH | Muhamet Halitaj | Drejtor | Drejtor mjekësor i spitalit rajonal të Pejës | 15-Oct-08 | PDK |
| 109 | Ministri | MSH | Nehat Baftiu | Drejtor | Drejtor i Klinikës së Anesteziologjisë dhe Reanimacionit | 1-Apr-07 | PDK |
| 110 | Ministri | MSH | Nisret Hajrullahu | Drejtor | Drejtor klinike në Spitalin Rajonal të Gjilanit | 3-Aug-12 | PDK |
| 111 | Ministri | MSH | Nurishahe Hulaj | Drejtor | Drejtoreshë e Institutit kombëtar të shëndetit publik - dega në Prizren | 1-Jun-99 | LDK/AAK |
| 112 | Ministri | MSH | Pajazit Pllana | Drejtor | Drejtor i Departamentit të degëve Internistike në Spitalin e Vushtrrisë | | LDK/LDD |
| 113 | Ministri | MSH | Ramadan Gjoni | Drejtor | Drejtor i Departamentit për Nëna dhe Fëmijë – Spitali Rajonal Vushtrri | 1-May-10 | LDK |
| 114 | Ministri | MSH | Remzije Zhushi | Zyrtar | Zyrtare e prokurimit në institutin e Kosovës për shëndetin publik (QKUK). | 1-Jan-05 | PDK |
| 115 | Ministri | MSH | Ramë Miftari | U.d Drejtor | U.d Drejtor I Shërbimit të Mjekësisë Nukleare | 15-Aug-12 | PDK |
| 116 | Ministri | MSH | Sejdë Tolaj | Drejtor | Drejtor i Administratës dhe Financave - Agjensioni i Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale | 6-Jul-11 | LDD/AAK |
| 117 | Ministri | MSH | Selvete Shurdhani | zv.Drejtor | Z.v Drejtore e spitalit rajonal të Gjilanit | 4-Aug-12 | PD |
| 118 | Ministri | MSH | Taib Alidemi | Drejtor | Drejtor i Qendres së Mjekësisë Familjare në Viti | 1-Mar-11 | PDK |
| 119 | Ministri | MSH | Drita Mekuli | Drejtor | Drejtoreshë e Repartit Endokrinologjik në QKUK | 6-Aug-12 | AKR-E15 |
| 120 | Ministri | MSH | Gani Muqolli | Drejtor | Drejtor operativ në spitalin rajonal Pejë | 1-Jul-99 | AAK |
| 121 | Ministri | MSH | Halit Ymeri | Drejtor | Ish-Drejtor i qëndres diagnostike - radiologjike - QKUK | 1-Nov-08 | LDD/AAK |
| 122 | Ministri | MSH | Xhavit Hajdari | Ish-Drejtor | Ish- drejtor i spitalit rajonal të Gjilanit | 10-Dec-07 | LDK |
| 123 | Ministri | MSH | Luan Gola | Shef i Kabinetit | Shef i Kabinetit të Diabetologjisë ka qenë edhe U.d Drejtor në Institutin për Mjekësi të Punës në Gjakovë | 15-Mar-10 | LDK |
| 124 | Ministri | MSH | Arianit Jakupi | U.d Drejtor | U.D i Kryeshefit të Agjensionit Kosovar për Produkte Mjekësore (AKPM) | 10-Sep-13 | LDK |
| 125 | Ministri | MZHE | Naim Zeqiri | Drejtor | Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun | 17-Mar-08 | PDK |
| 126 | Ministri | MIE | Pleurat Sejdiu | Drejtor | Drejtor për marrëdhënie me publikun në Agjencinë për Integrime Evropianë | 1-Apr-07 | PDK |
| 127 | Kryeministria | ZKM | Refike Sulçevsi | Drejtor | Drejtoreshë e departamentit për politika zhvillimore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave | 1-Oct-09 | Partia Demokratike Turke |
| 128 | Kryeministria | ZKM | Shaban Gollopeni | U.d Drejtor | U.D drejtor i Drejtorisë së Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë | 10-Jul-12 | PDK/NISMA |
| 129 | Kryeministria | ZKM | Ramë Manaj | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës | 15-Aug-11 | LDK |
| 130 | Kryeministria | ZKM | Ismet Cakiqi | Koordinator | Koordinator i Zyrës së Komunikimit në Zyrën e Kryeministrit | 20-Aug-02 | PDK |
| 131 | Ministri | MFSK | Faruk Geci | Drejtor | Drejtor i departamentit për politika dhe plane | 1-Jul-09 | PDK |
| 132 | Ministri | MPB | Driton Gashi | Sekretar | Sekretar i përgjithshëm në MPB nga viti 2014, Drejtor i Departamentit për Siguri Publike MPB Tetor 2010 – qershor 2013 | 5-Jun-13 | PDK |
| 133 | Ministri | MSH | Ali Sadriu | Drejtor | Drejtor i QKUK-së | 4-Nov-09 | LDK |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kandidat për asamble komunale në KK Prishtinë - 2007 - 2009. | | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Ka qenë këshilltare politike e ish-ministrit të MAP Arsim Bajrami 2008-2010. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidate për deputete në Kuvendin e Kosovës - 2014. | | | | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Anëtar i kryesisë së degës së PDK-së në Klinë. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Klinë |
| Këshilltar komunal nga PDK në Suharekë (01 Jan 2010). Anëtar i kryesisë së degës së PDK-së në Suharekë. | | | | ✓ | | Suharekë |
| Asambleist komunal nga PDK në Malishevë | | | | ✓ | ✓ | Malishevë |
| Njëri nga themeluesit e LDK-së. I Afërt me LDK-në. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Prishtinë |
| Aktivist i LDK-së. E ka përfaqësuar LDK-në në debate zgjedhore me 2014. Ka marrë pjesë në fushatën e LDK-së. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Deçan |
| Asambleist në KK Prishtinë nga LDK 2009-2013. Kandidat per asamble 2013. | | | | ✓ | | Prishtinë |
| Aktivist i LDK-së. Ka marrë pjesë në fushatë dhe në mbledhje të forumit rinor. Djali i Shaban Manajt, veprimtar i hershëm i LDK-së që është vrarë pas lufte. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Istog |
| Anëtar i kryesisë së re të PDK-së në Prizren. Ka aderuar në PDK me 2010. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Kandidat për kryetar të Malishevës, kandidat për deputet. Ka fituar në zgjedhjet e 2014. | ✓ | | | | | Malishevë |
| Anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së. Kandidat për deputet më 2014. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Dragash |
| Kandidat për asamble KK Mitrovicë 2007. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Mitrovicë |
| Kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës ne vitin 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Dragash |
| Kandidat për asambleist në KK Prishtinë me 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Këshilltar komunal dhe shef i grupit të këshilltarëve të PDK-së - KK Malishevë. | | | ✓ | ✓ | | Malishevë |
| Kandidat për kryetar të Pejës me 2009. Këshilltar komunal më 2007. Ka qenë kryetar i degës së PDK-së në Pejë. | | ✓ | ✓ | ✓ | | Pejë |
| Asambleist i PDK - Skenderaj - 2007 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Skënderaj |
| Asambleiste nga LDD - 2007. Drejtoreshë e drejtorisë së financave në Ferizaj. 2004 | ✓ | ✓ | ✓ | | | Ferizaj |
| Kandidat për asamble nga ORA | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Klinë |
| Ka qenë këshilltar politike i Ministrit Enver Hoxhaj në MASHT dhe në MPJ. | | ✓ | ✓ | ✓ | | Prishtinë |
| Ka qenë ministër i Ekonomisë dhe Financave | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për deputet - 2010. Kandidat për asamble KK Prishtinë - 2009 dhe 2007 | | | | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për deputet në KK Dragash - 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Dragash |
| Ka qenë këshilltar në Zyrën e Kryeministrit Thaçi. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Rahovec |
| Deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e PDK-së (2007-2010) | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë deputete e LDK-së 2004-2007. Kandidate për deputete dhe për asamble KK Prizren nga LDK më 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Kandidat për deputet nga PDK - 2007. Ka qenë anëtar i Kryesisë së PDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Podujevë |
| Kandidat për deputet nga AKR - 2007. Anetar i kryesisë së AKR-së. Në vitin 2010 u emërua Këshilltar për Marrëdhënie me Jashtë i Presidentit Pacolli. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Kamenicë |
| Kandidat për kryetar të Prishtinës -2007. Njeri nga themeluesit e ORA-s. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për deputet - 2007. Këshilltar i presidetit Rugova. Aktivist i hershëm i LDK-së, familjar i Sabri Hamitit | ✓ | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Asambleist i PDK-së në KK Gjilan dhe ka udhëhequr komitetin për shëndetësi në kuadër të Asamblesë Komunale. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Asambleist në KK Gjakovë - 01 Jan 2009 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Ka qenë kandidat për deputet nga LDD më 2007 dhe kandidat nga AAK më 2014. (Aktivistet e LDD-së kanë konkurruar në listën e AAK-së në zgjedhjet e vitit 2014) | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për asamble komunale në Vushtrri nga AAK - 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Asambleist në KK Pejë nga viti 2009. Ka fituar edhe në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2013. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Ka qenë kandidat për deputet nga LDK në vitin 2010 dhe anëtar i këshillit të përgjithshëm të LDK-së. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Ka qenë kandidate për asamble komunale në Mitrovicë - 2007. Asambleiste në KK Mitrovicë 2004. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Mitrovicë |
| Është zgjedhur deputet në zgjedhjet e fundit - 2014. Ka qenë kandidat për deputet edhe në vitin 2010. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Kandidat për asamble KK Gjilan më 2007 dhe 2009. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Asambleist nga LDK në KK Gjilan - 2013. Kryetar i Komisionit për Shëndetësi në degën e LDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës-2007. Anëtar i komitetit për arsim nga AAK - 2014. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Kandidat për deputet - 2007. | | | | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Kandidat për kryetar të Pejës. Ka qenë për tri mandate këshilltar komunal nga radhët e PDK-së. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Kandidat për asamble KK Ferizaj - 2013 dhe kandidat për deputet më 2014. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Asambleist në KK Gjilan. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Tri herë ka qenë deputete (legjislatura parlamentare 1, 2 dhe 3). Kandidate për deputete më 2010 nga LDD | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Asambleist nga LDD në KK Vushtrri. Kandidat për deputet më 2007 dhe 2010 nga LDD. Kandidat për asamble nga LDK 2013. | | ✓ | ✓ | ✓ | | Vushtrri |
| Asambleist në KK Vushtrri 2002 dhe 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Asambleiste në KK Prishtinë - 2004 deri 2009. (në dy mandate) | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për asamble KK Prishtinë. Ish-drejtor i Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për deputet nga LDD. Sekretar i kesaj partie. I është bashkangjitur AAK-së në mars 2013 dhe ka qenë kandidat për deputet nga kjo parti më 2014. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Deçan |
| Kryetare e degës se PD-së në Gjilan. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Asambleist në KK Viti - është zgjedhur më 2013 | | | | ✓ | ✓ | Viti |
| Kandidate për deputete nga E-15, grup që ka garuar në listën e AKR-së - 2010. | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Asambleist në KK Pejë 2009 - 2013 Kandidat për asamble 2007. | ✓ | ✓ | ✓ | | | Pejë |
| Ka qenë kandidat për KK Prishtinë - 2007. Kandidat për deputet nga AAK 2014. | ✓ | ✓ | ✓ | | | Istog |
| Kandidat për deputet - 2007 dhe anëtar i kryesisë së degës së LDK-së në Gjilan | ✓ | ✓ | ✓ | | | Gjilan |
| Kryesues i Kuvendit Komunal - Gjakovë. Kandidat për kryetar të Gjakovës. Kryetarës i degës së LDK-së në Gjakovë. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| 2008-2010 ka qenë këshilltar i ministrit Alush Gashi | | | | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Anëtar i Këshillit drejtues të degës së PDK-së në Prishtinë | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Kryetare e Partisë Demokratike Turke | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Asambleist KK Suharekë gjatë 2010-2013, kandidatë për deputet I NISMA në vitin 2014 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Suharekë |
| Ka qenë sekretar i përgjithshem i LDK-së. Deputet nga LDK | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Klinë |
| Asambleist në KK Podujevë - 2010 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Podujevë |
| Anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Skënderaj |
| Ish-këshilltar i ministrit Zenun Pajaziti në MPB, anëtar i kryesisë së degës së PDK-së në Prishtinë | | | | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë ministër për Ekonomi dhe Financa 2002-2004, deputet në Kuvendin e Kosovës në legjislaturat I, II, IV | ✓ | | | | | Prishtinë |

> VAZHDON NË FAQE 8

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 134 | Ministri | MPJ | Lirim Grajçevci | Ambasador | Ambasador në Britani | 15-Dec-12 | PDK |
| 135 | Ministri | MPJ | Ramiz Lladrovci | Ambasador | Ambasador në Shqipëri | 1-Aug-14 | PDK |
| 136 | Institucion I Pavarur | Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | Ruzhdi Jashari | Mbikqyrës | Mbikqyrës | 23-Jun-11 | PDK |
| 137 | Ndermarrje Publike | Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës | Bislim Zogaj | Drejtor | Drejtor | 24-Dec-08 | PDK |
| 138 | Ndermarrje Publike | Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës | Besnik Krasniqi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Apr-09 | PDK |
| 139 | Ndermarrje Publike | Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës | Hanefi Muharremi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 24-Apr-09 | LDK |
| 140 | Ndermarrje Publike | Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës | Naser Canolli | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-May-06 | PDK |
| 141 | Ndermarrje Publike | Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës | Agron Mustafa | Drejtor | Drejtor menxhues | 3-Mar-08 | PDK |
| 142 | Ndermarrje Publike | K.R.U.K. Bifurkacioni | Asllan Shabani | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Mar-09 | PDK |
| 143 | Ndermarrje Publike | k.R.U.K. Bifurkacioni | Ylber Topalli | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 3-Jan-09 | PDK |
| 144 | Ndermarrje Publike | Kompania Kosovare për Distribucion dhe Furnizim të Energjisë | Burim Basha | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 19-Dec-12 | AKR |
| 145 | Ndermarrje Publike | Kompania Hidroregjioni Jugor Sh.A | Liman Gashi | Zyrtar | Zyrtar Kryesor Financiar | 2-Aug-10 | LDD |
| 146 | Ndermarrje Publike | KUR Prishtina | Adem Duriqi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 24-Dec-08 | LDK |
| 147 | Ndermarrje Publike | KUR Prishtina | Bajram Jashari | Drejtor | Drejtor | 24-Dec-08 | PDK |
| 148 | Ndermarrje Publike | KUR Prishtina | Kujtim Xhelili | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 24-Dec-08 | PDK |
| 149 | Ndermarrje Publike | KUR Prishtina | Selatin Retkoceri | Zyrtar | Zyrtar Kryesor Financiar | 10-Oct-11 | PDK |
| 150 | Ndermarrje Publike | Rajonale e Mbeturinave Ambienti | Demë Abazi | Drejtor | Drejtor i Bordit | 21-Feb-11 | AAK |
| 151 | Ndermarrje Publike | Rajonale e Mbeturinave Ambienti | Gani Luta | Zyrtar | Zyrtar i prokurimit | 22-Dec-04 | AAK |
| 152 | Ndermarrje Publike | Kompania e mbeturinave Cabrati | Gëzim Qarri | Drejtor | Drejtor | 1-Mar-08 | ORA |
| 153 | Ndermarrje Publike | NP Eko-Rexhioni | Hasan Hasani | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 1-Jan-10 | PDK |
| 154 | Ndermarrje Publike | NP Eko-Rexhioni | Perparim Krasniqi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-May-11 | AAK-LDD |
| 155 | Ndermarrje Publike | NP Eko-Rexhioni | Remzi Kololli | Anëtar i bordit | Anetar i bordit | 1-Sep-09 | LDK |
| 156 | Ndermarrje Publike | NP Eko-Rexhioni | Sadik Paçarizi | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 1-Jun-08 | PDK |
| 157 | Ndermarrje Publike | NP Eko-Rexhioni | Xhamali Haxhimustafa | Drejtor | Drejtor gjeneral | 26-Mar-10 | PDK |
| 158 | Ndermarrje Publike | Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" | Feim Salihu | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv | 1-Feb-11 | LDK |
| 159 | Ndermarrje Publike | Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" | Fitim Selimi | Drejtor | Drejtor Joekzekutiv | 1-Jan-10 | AAK-LDD |
| 160 | Ndermarrje Publike | Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" | Kemail Hashani | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 3-Feb-11 | LDK |
| 161 | Ndermarrje Publike | Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" | Kadri Retkoceri | Ish-Drejtor | Ish-drejtor menaxhues | 23-Apr-04 | LDK |
| 162 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Mbeturinave Pastërtia | Fatmir Zymeri | Zyrtar | Zyrtar i financave | 16-Apr-11 | LDK |
| 163 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Mbeturinave Pastërtia | Gazmend Bytyçi | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv | 2-Feb-10 | PDK |
| 164 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Mbeturinave Pastërtia | Hajrie Nebihi | Drejtor | Drejtor jo ekzekutiv | 19-Mar-09 | PDK |
| 165 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Mbeturinave Pastërtia | Skënder Ferizi | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 19-Mar-09 | PDK |
| 166 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Mbeturinave Pastërtia | Gojart Bajrami | Drejtor | Drejtor i bordit | 29-Jun-10 | PDK |
| 167 | Ndermarrje Publike | Kompania R e Mbeturinave Uniteti | Eset Shaqiri | Zyrtar | Zyrtar i lartë financiar | 8-Jan-10 | PD |
| 168 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Rasim Maloku | Auditor i brendshëm | Auditor i brendshëm | 13-Apr-11 | AAK |
| 169 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Shkelzen Hyseni | Kryetar i bordit | Kryetar i bordit | 24-Dec-08 | LDK |
| 170 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Azem Mujku | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 24-Dec-08 | PDK |
| 171 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Samet idrizi | Zyrtar | Zyrtar i prokurimit | 13-Jan-05 | PDK |
| 172 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Xhelal Shabani | Zyrtar | Zyrtar kryesor financiar | 25-May-10 | LDK |
| 173 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Mitrovica | Muhamet Salihu | Zyrtar | Zyrtar kryesor financiar | 18-Jan-10 | PDK |
| 174 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Nystret Gerxhaliu | Anëtar i bordit | Anetar i bordit | 1-Jan-09 | PDK |
| 175 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Artan Nimani | Drejtor | Drejtor i Bordit | 1-Jan-09 | PDK |
| 176 | Ndermarrje Publike | Kompania R. e Ujesjellesit Hidrodrini | Ruzhdi Këpuska | Kryetar i bordit | Kryetar i Bordit | 1-Jan-09 | LDK |
| 177 | Ndermarrje Publike | Kompania e Ujitjes Drini I Bardhe | Fadil Kabashi | Drejtor | Drejtor i bordit | 24-Dec-08 | PDK |
| 178 | Ndermarrje Publike | Kompania e Ujitjes Drini I Bardhe | Leonora Bajraktari | Zyrtar | Zyrtare kryesore financiare | 13-Aug-12 | LDD |
| 179 | Ndermarrje Publike | Kompania e Ujitjes Drini I Bardhe | Shkodran Gaxherri | Drejtor | Drejtor i bordit | 14-Jan-10 | LDK |
| 180 | Ndermarrje Publike | Kompania e Ujitjes Radoniqi-dugagjini | Avdullah Kryeziu | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Jan-09 | LDK |
| 181 | Ndermarrje Publike | Kompania e Ujitjes Radoniqi-dugagjini | Canë Delija | Anëtar i bordit | Anetar i bordit | 1-Jan-09 | LDK |
| 182 | Ndermarrje Publike | Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dugagjini | Ismet Neziraj | Drejtor | Drejtor i bordit | 1-Jan-09 | PDK |
| 183 | Ndermarrje Publike | KEK | Agim Nika | Drejtor | Drejtor | 24-Dec-08 | PDK |
| 184 | Ndermarrje Publike | KEK | Enver Muli | Drejtor | Drejtor i bordit | 7-Oct-13 | LDK |
| 185 | Ndermarrje Publike | KEK | Fadil Çitaku | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit të drejtoreve | 1-Jan-09 | LDK |
| 186 | Ndermarrje Publike | KEK | Izet Ibrahimi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Sep-11 | PDK |
| 187 | Ndermarrje Publike | KEK | Pranvera Dobruna-Kryeziu | Drejtor | Drejtor Joekzekutiv | 7-Oct-13 | AAK |
| 188 | Ndermarrje Publike | Ibër Lepenc | Demë Abazi | Drejtor | Drejtor | 2-Mar-11 | AAK |
| 189 | Ndermarrje Publike | Ibër Lepenc | Hajdar Beqa | Kryeshef | Kryeshef Ekzekutiv | 9-Jul-09 | PDK |
| 190 | Ndermarrje Publike | Ibër Lepenc | Sheremet Smakolli | Zyrtar | Zyrtar kryesor financiar | 29-Jan-10 | LDK |
| 191 | Ndermarrje Publike | NP Infrakos SHA | Fadil Krasniqi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 10-Apr-09 | LDK |
| 192 | Ndermarrje Publike | NP Infrakos SHA | Naser Hoti | Drejtor | Drejtor | 1-Sep-11 | PDK |
| 193 | Ndermarrje Publike | NP Trainkos SHA | Betim Gjoshi | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv | 1-Oct-12 | PDK |
| 194 | Ndermarrje Publike | NP Trainkos SHA | Heset Cakolli | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 22-Aug-11 | AKR |
| 195 | Ndermarrje Publike | NP Trainkos SHA | Labinot Halilaj | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 20-Jul-11 | PDK |
| 196 | Ndermarrje Publike | NP Trainkos SHA | Liridon Restelica | zv. Kryeshef | zv. Kryeshef ekzekutiv | 1-Feb-12 | PDK |
| 197 | Ndermarrje Publike | NP Trainkos SHA | Shkumbin Hyseni | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 20-Jul-11 | PDK |
| 198 | Ndermarrje Publike | NP Trainkos SHA | Zair Imeri | Zyrtar | Zyrtar kryesor financiar | 2013 | PDK |
| 199 | Ndermarrje Publike | Ndermarrja Publike Banesore, Prishtine | Sevdie Alshiqi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 17-Oct-12 | LDK |
| 200 | Ndermarrje Publike | Ndermarrja Publike Banesore, Prishtine | Banush Pacolli | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 29-Apr-09 | AKR |
| 201 | Ndermarrje Publike | Hortikultura | Arton Shabani | Auditor i brendshëm | Auditor i brendshëm | 5-Oct-09 | LDK |
| 202 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë | Astrit Dema | Drejtor | Drejtor ekzekutiv | 14-Feb-10 | AAK |
| 203 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë | Flamur Babalija | Drejtor | Drejtor Joekzekutiv | 15-Sep-12 | AAK |
| 204 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë | Nurije Haxhikadrija | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 11-Sep-12 | AAK |
| 205 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë | Mark Komani | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 6-Jan-09 | PSHDK |
| 206 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Termokos | Fëllanza Pula | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv | 14-Mar-08 | PDK |
| 207 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Termokos | Arsim Janova | Kryeshef | Kryeshef i bordit ekzekutiv | 8-Aug-11 | LDK |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ish-këshilltar i Hashim Thaçit | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Ka qenë deputet i PDK | | | | | ✓ | Drenas |
| Asambleist në KK Shtime 2007/2009 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Shtime |
| PDK, anëtar i degës në Drenas | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Drenas |
| Asambleist në KK Prizren 2007-2009 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Kandidat i LDK-së për kryetar të Prizrenit, në zgjedhjet 2009 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Anëtar i Këshillit Drejtues të PDK | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Anëtar i Këshillit Drejtues të PDK | ✓ | ✓ | | | | Prishtinë |
| Asambleist në KK të Ferizajt nga PDK | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Ferizaj |
| Asambleist në KK Ferizaj 2011, nga PDK | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Ferizaj |
| Asamblesit në KK të Pejës prej 2010 nga AKR | | | ✓ | ✓ | | Pejë |
| Kandidat i LDD për këshilltar komunal në Suharekë | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Suharekë |
| Kandidat i LDK për këshilltar komunal në lipjan në zgjedhjet 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Lipjan |
| Kandidat për kreun e PDK në Prishtinë | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kryesues i Kuvendit në Shtime 2009-2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Shtime |
| Këshilltar komunal nga PDK - Lipjan, më 2007 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Lipjan |
| Kandidat i AAK për këshilltar komunal në Pejë në zgjedhjet 2007 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Përfaqeson nëndegën e AAK në fshatin Kapeshnicë | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Kandidat për këshilltar komunal më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Këshilltar komunal i PDK në Prizren më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prizren |
| Drejtor në Komunën e Rahovecit | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Rahovec |
| Kandidat nga LDK për këshilltar në Suharekë më 2007, 2009, 2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Suharekë |
| Drejtor i urbanizmit në Komunen e Prizrenit | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Prizren |
| Këshilltar i PDK në asamblene e Rahovecit | ✓ | ✓ | ✓ | | | Rahovec |
| Këshilltar komunal i LDK, Prishtinë | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për kryetar komune nga AAK-LDD për në Lipjan më 2013. Ka qenë ndër njerëzit kryesor të PDK-së deri në këto zgjedhje. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Lipjan |
| Kandidat për asambleist në KK të Obiliqt në zgjedhjet e 2009 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Obiliq |
| Kandidat më 2009 për asambleist të KK Lipjan | ✓ | | | | | Lipjan |
| Kandidat për kryetar të Shtimës më 2013 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Shtime |
| PDK-sekretar dege i PDK në Ferizaj | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Këshilltare komunale 2009-2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Ferizaj |
| Kandidat për këshilltar komunal në Ferizaj | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Ferizaj |
| Kandidat më 2009 për asambleist të KK të Shtimës | ✓ | ✓ | | | | Shtime |
| Këshilltar komunal në Mitrovicë nga PD | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Mitrovicë |
| Këshilltar komunal në Junik 2009-2013 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Junik |
| Kandidat për këshilltar komunal më 2009 në Pejë | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Këshilltar komunal në KK Gjilan 2002 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Këshilltar komunal në Viti | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Viti |
| Kandidat për këshilltar komunal nga LDK me 2009 për Gjilan | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjilan |
| Kandidat i PDK për këshilltar komunal në Komunën e Obiliqit më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Obiliq |
| Këshilltar komunal në Vushtrri 2009-2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Kandidat për keshilltar komunal në Gjakovë më 2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Gjakovë |
| Këshilltar komunal më 2007 në Gjakovë | ✓ | ✓ | | | | Gjakovë |
| Kandidat për asamble komunale në Istog më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Istog |
| Kandidate për asambleiste në Komunën e Klinës më 2007 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Klinë |
| Këshilltar komunal në Junik më 2010 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Junik |
| Këshilltar komunal në Rahovec më 2009 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Rahovec |
| Kandidat për këshilltar komunal në Gjakovë më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Kandidat për këshilltar për Deçan më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Deçan |
| Anetar i PDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Prishtinë |
| Kandidat për asmblen e Vushtrrisë më 2007 | | | | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Anëtar i LDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Prishtinë |
| ish-kryetar i Drenasit | | ✓ | ✓ | ✓ | | Drenas |
| Kandidate e AAK-së, për Kuvendin e Kosovës më 2014 | | | | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat i AAK për këshilltar komunal në Pejë në zgjedhjet 2007. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Kandidat i PDK për kryetar të Gjakovës më 2013 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Kandidat i LDK për zgjedhjet komunale 2009, në Vushtrri | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Vushtrri |
| Nënkryetar i Komunes së Fushë-Kosovës më 2009 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Fushë Kosovë |
| Këshilltar komunal në Fushë-Kosovë në mandatin e kaluar | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Fushë Kosovë |
| Perfaqesues i PDK në KQZ | | | ✓ | ✓ | ✓ | Fushë Kosovë |
| Këshilltar komunal në Ferizaj më 2007 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Ferizaj |
| Pjesëmarrës në fushatën e PDK-së | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Drenas |
| Këshilltar komunal në Prishtinë më 2009 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për këshilltar komunal në Pejë më 2007 | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Pejë |
| Këshilltar komunal në Skenderaj më 2009 | | | | ✓ | ✓ | Skënderaj |
| Kandidate për deputete më 2010 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat i AKR për deputet në Kuvendin e Kosovës më 2014 | ✓ | ✓ | ✓ | | | Prishtinë |
| Sekretar organizativ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |
| Kandidat për asamblesit në Komunën e Gjakovës më 2007 | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Gjakovë |
| Kandidat për Asamble të Gjakovës më 2009 | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Kryetare e forumit të gruas AAK-Gjakovë | | | ✓ | ✓ | ✓ | Gjakovë |
| Nënkyetar i PSHDK-së | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | Gjakovë |
| Këshilltare e PDK-së më 2007 e Kuvendit Komunal të Prishtinës | ✓ | ✓ | | | | Prishtinë |
| Këshilltar komunal në Prishtinë më 2007, zëvendësministër i drejtësisë. | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Prishtinë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 208 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja e Qytetit, Termokos | Imer Hamiti | Kryetar i bordit | kryesues i bordit | 25-Jun-11 | AAK |
| 209 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Aziz Pacolli | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Jan-12 | AKR |
| 210 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Ejup Qerimi | Kryeshef | Kryeshef ekzekutiv (është shkarkuar më 01.10.2014) | 17-Jun-11 | PDK |
| 211 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Rexhë Gjonbalaj | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 9-Jul-08 | PDK |
| 212 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Halit Isufi | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 21-Mar-12 | PDK |
| 213 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Qamil Buzhala | Drejtor | Drejtor i bordit | 24-Dec-08 | LDK |
| 214 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Arben Rogova | Menaxher | Menaxher regjional në Gjakovë | 15-Feb-13 | PDK |
| 215 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Shefqet Avdija | zv. Kryeshef | zv.kryeshef | | PDK |
| 216 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Zair Imeri | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Mar-12 | PDK |
| 217 | Institucion I Pavarur | Agjencia Kosovare e Privatizimit | Agim Jusufi | Drejtor | Drejtor | 1-Jan-09 | LDK |
| 218 | Institucion i Pavarur | Agjencia Kosovare e Privatizimit | Blerim Rexha | Kryetar i bordit | Kryetar i bordit | 21-Feb-13 | PDK |
| 219 | Institucion i Pavarur | Agjencia Kosovare e Privatizimit | Hilmi Haxha | Shef | Shef | 1-Jan-10 | LDK |
| 220 | Institucion i Pavarur | Agjencia Kosovare e Privatizimit | Mrika Tahiri | zv. Drejtor | zv.drejtor ne AKP | 1-Apr-10 | PDK |
| 221 | Institucion i Pavarur | Agjencia Kosovare e Privatizimit | Shefik Mehmeti | Drejtor | Drejtor | 1-Jan-10 | LDK |
| 222 | Institucion i Pavarur | Agjencia Kosovare e Pronës | Ismail Osdautaj | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 15-May-12 | AKR |
| 223 | Institucion i Pavarur | Autoriteti Kosovar i Konkurrencës | Ahmet Krasniqi | zv. Kryetar | zv. Kryetar | 7-Nov-08 | PDK |
| 224 | Institucion i Pavarur | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave | Halit Gara | Kryetar i bordit | Kryesues i bordit | 2-Apr-10 | PDK |
| 225 | Institucion i Pavarur | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave | Ilmi Ahmeti | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Apr-10 | LDK |
| 226 | Institucion i Pavarur | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave | Jakup Bellaqa | Kryesues | Kryesues i departamentit | 2-Apr-12 | AAK |
| 227 | Institucion i Pavarur | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave | Murtez Zekolli | Kryesues | Kryesues i departamentit | 15-Nov-10 | PDK |
| 228 | Institucion i Pavarur | Banka Qëndrore | Agron Dida | Ish-Shef | Ish-Shef | 1-Feb-07 | AAK-VETEVENDOSJE |
| 229 | Institucion i Pavarur | Banka Qëndrore | Bedri Hamza | Guvernator | Guvernator në BQK | 27-Mar-13 | PDK |
| 230 | Institucion i Pavarur | Banka Qëndrore | Sejdi Rexhepi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 13-Jun-08 | PDK |
| 231 | Institucion i Pavarur | Fondi I Kursimeve Pensionale | Driton Qehaja | Anetar i bordit | Anëtar i bordit | 1-Aug-12 | PDK |
| 232 | Institucion i Pavarur | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik | Safet Hoxha | Kryetar i bordit | Kryetar i Bordit | 8-Jul-10 | PDK |
| 233 | Institucion i Pavarur | Komisioni i Pavarur i Medieve | Shefki Ukaj | Kryetar | Kryetar i komisionit | 30-Aug-12 | LDK |
| 234 | Institucion i Pavarur | Komisioni i Pavarur i Medieve | Sylejman Klinaku | Anëtar i bordit të ankesave për media | Anëtar i bordit të ankesave për media | 5-Nov-12 | PDK |
| 235 | Institucion i Pavarur | Komisioni i Pavarur i Medieve | Vesna Jovanoviç | Anëtar i Komisionit | Anëtar i Komisionit | 24-Jan-13 | Iniciativa Qytetare Serbe për Parteshin |
| 236 | Institucion i Pavarur | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale | Ahmet Tmava | Kryesues | Kryesues | 28-Jan-10 | PDK |
| 237 | Institucion i Pavarur | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale | Ibush Jonuzi | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 28-Jan-10 | LDK |
| 238 | Institucion i Pavarur | Zyra e Rregullatorit për Uje dhe Mbeturina | Mejrem Cernobregu | Kryesues | Kryesuese e departamentit | 1-Jun-11 | ORA |
| 239 | Institucion i Pavarur | AKP | Naser Osmani | Drejtor | Drejtor në AKP | 16-Feb-11 | LDK |
| 240 | Institucion i Pavarur | KPM | Adnan Merovci | Kryetar | Kryetar i KPM-së | 19-Mar-14 | PDK |
| 241 | Institucion i Pavarur | OSHP | Hysni Hoxha | Kryetar | Kryetar i OSHP-së | 31-Jul-08 | PDK |
| 242 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Xhevdet Smakiqi | U.d Drejtor | U.d drejtor në PTK | 8-Nov-12 | PDK |
| 243 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosoves | Gani Sylaj | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit në PTK | 24-Dec-08 | PDK |
| 244 | Ndermarrje Publike | Posta e Kosovës | Menduh Abazi | Drejtor | Drejtor për informim në PTK | 31-Mar-11 | PDK |
| 245 | Institucion I Pavarur | Agjencia Kosovare e Privatizimit | Ferat Shala | Ish- Drejtor | Ish- Drejtor i "Trepçes" | 15-Dec-08 | PDK |
| 246 | Ndermarrje Publike | Ngrohtorja Termokos | Asdren Osaj | Drejtor | Drejtor i Bordit | 1-Jun-11 | LDK |
| 247 | Ministri | MPB | Ekrem Abazi | Zyrtar | Zyrtar për patent shofer | 1-Mar-03 | LDD |
| 248 | Ministri/Up | MASHT | Skënder Ahmeti | Dekan | Dekan në Fakultetin Ekonomik | 1-Oct-10 | PDK |
| 249 | Institucion i Pavarur | Fondi I Kursimeve Pensionale | Ruzhdi Morina | Anëtar i bordit | Anëtar i bordit | 30-Apr-09 | PDK |
| 250 | Ministri | MPJ | Ramadan Avdiu | Konsull | Konsull i përgjithshëm në Konsullatën e Përgjithshme në Gjenevë | 12-Nov-13 | PDK |

VAZHDON NGA FAQJA 03

vitet e fundit pas vitit 2010), të numrit të zyrtarëve që janë punësuar në poste të larta publike në baza partiake. Një rënie e lehtë e të punësuarve me lidhje partiake në pozita të larta publike vërehet në vitin 2014. Por kjo rënie mund të jetë rezultat i mungesës së të dhënave rreth të punësuarve të rinj gjatë vitit 2014, sepse në kohën kur është realizuar grumbullimi dhe analizimi i të dhënave për nevoja të këtij hulumtimi, regjistrat e deklarimit të pasurisë për vitin 2014 nuk kanë qenë të publikuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK).

## INSTITUCIONET E PAVARURA NË DUAR TË PUSHTETARËVE

Hulumtimi i Preportr, ka treguar se politizimi i pozitave të larta në institucione publike përveçse është i pranishëm në administratën publike, prekë edhe institucionet e pavarura si: agjencitë, rregullatorët e ndryshëm dhe ndërmarrjet publike.

Në institucione të pavarura punojnë 28 zyrtarë me pozita vendimmarrëse për të cilat Preportr, ka gjetur fakte se kanë lidhje me partitë politike.

Sidoqoftë, për dallim prej institucioneve tjera ku ka ndërrime më të shpeshta të zyrtarëve, në institucionet e pavarura nuk ka lëvizje të shpeshta. Nga 28 zyrtarë të lartë me pozitë vendimmarrëse, 25 janë duke punuar ende.

Tek institucionet e pavarura duhet veçuar se PDK-ja ka ndikim në institucionet kryesore që lidhen me aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë. Kryetari i 'gjykatës së tenderëve' - OSHP-së, ka qenë asambleist i PDK-së në Komunën e Prizrenit, përderisa kryetari i Bordit të KRPP-së ka qenë po ashtu asambelist i PDK-së në Komunën e Therandës.

Për ta kuptuar më mirë dhe nga një perspektivë më e gjerë rëndësinë e institucioneve përgjegjëse në fushën e prokurimit publik, duhet të merret në konsideratë fakti se vetëm pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 2008 e deri më 2013, autoritetet publike kontraktuese kanë shpenzuar afër 3,6 miliardë euro në prokurime publike. Këtu nuk hyjnë edhe shpenzimet për autostradën "Ibrahim Rugova", e cila nga viti 2010 deri më 2013 i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 789 milionë euro.

Vendosja e individëve me përkatësi të qartë partiake në institucionet kryesore të prokurimit publik paraqet faktor dominant jo vetëm në ngritjen dhe konsolidimin e patronazhit politik por edhe në krijimin dhe shtrirjen e një kulture klienteliste tek partitë politike.

Në një hulumtim të mëhershëm të Preportr, tregohet se shtrirja e klientelizmit tek partitë politike ka përmasa shqetësuese. Nga hulumtimi është treguar se vetëm brenda viteve 2008-2010, dhe atë vetëm nga dy ministri - ajo e Transportit (tash e Infrastrukturës) dhe ajo e Arsimit - janë shpërndarë rreth 100 milionë euro tek financuesit e partisë më të madhe politike - PDK. Hulumtimet e Preportr, kanë gjetur fakte se klientelizmi - dhënia e tenderëve financuesve të partive politike - është i pranishëm edhe në nivel komunal, ku kanë udhëhequr ose udhëheqin partitë tjera si LDK dhe AAK.

Ky politizim i institucioneve publike përveç se bëhet për arsye të shpërblimit, duket se bëhet edhe për qëllime të vendosjes së kontrollit mbi sasinë dhe cilësinë e të dhënave zyrtare që bëhen publike. Një rast i tillë është shënuar kur kreu i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ish-kryesues i Kuvendit Komunal të

### ZYRTARË TË LARTË PUBLIK QË PUNOJNË NËPËR INSTITUCIONE TË PAVARURA E QË KANË LIDHJE PARTIAKE:

**28 ZYRTARË TË LARTË PUBLIK ME POZITË VENDIMMARRËSE PUNOJNË NË INSTITUCIONE TË PAVARURA;**

- 6 anëtarë të bordeve;
- 1 anëtar i bordit të KPM-së;
- 1 anëtar i Komisionit në KPM;
- 4 drejtorë;
- 1 guvernator;
- 4 kryesues të departamenteve;
- 2 kryetarë të Komisionit të Pavarur të Medieve (njëri është shkarkuar),
- 3 kryetarë të bordeve;
- 1 mbikëqyrës kryesor në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 2 shefa;
- 1 z.v drejtore në AKP;
- 1 z.v kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, dhe;
- 1 kryetar i OSHP-së;

**NGA KËTA 28 ZYRTARË TË LARTË ME POZITË VENDIMMARRËSE NË INSTITUCIONE TË PAVARURA:**

- 16 nga PDK;
- 7 nga LDK;
- 2 nga AAK;
- 1 nga AKR;
- 1 nga ish-partia ORA, dhe;
- 1 nga Iniciativa Qytetare Serbe për Parteshin.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Asamblesit në KK të Prishtinës më 2007 | | √ | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Asamblesit në KK të Prishtinës në dy mandate | | | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Këshilltar në KK Gjilan në vitet 2002-2005. Ka deklaruar publikisht se që 10 vjet është pjesë e PDK-së. Dega e PDK-së së Gjilanit e ka propozuar për deputet në zgjedhjet e vitit 2014, por që nuk ka kandiduar | | √ | √ | √ | √ | Gjilan |
| Anëtar i degës në Pejë | √ | √ | √ | √ | √ | Pejë |
| Anëtar i degës së PDK, në Gjakovë | | | √ | √ | √ | Gjakovë |
| Këshilltar komunal në Prizren nga LDK më 2007 | √ | √ | √ | √ | | Prizren |
| Këshilltar komunal në Gjakovë nga PDK | | | | √ | | Gjakovë |
| Anëtar i degës PDK në Gjakovë | | | | √ | √ | Gjakovë |
| Këshilltar i PDK në KK të Skenderajt më 2010 | | | √ | √ | √ | Skënderaj |
| Kandidat për këshilltar komunal në Mitrovicë më 2007 | √ | √ | √ | √ | √ | Mitrovicë |
| Kandidat i PDK-së për deputet | | | | √ | √ | Prishtinë |
| Këshilltar në KK Mitrovicë në mandatin 2007 | √ | √ | √ | √ | √ | Mitrovicë |
| Kandidate për deputete me 2010 | √ | √ | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Kandidat për këshilltar në KK të Mitrovicës më 2013 | √ | √ | √ | √ | √ | Mitrovicë |
| Kandidat për Asamble të Prishtinës më 2007 | | | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Këshilltar komunal në Fushë-Kosovë në mandatin 2010-2013 | √ | √ | √ | √ | √ | Fushë Kosovë |
| Përkrahës i PDK | √ | √ | √ | √ | √ | Prishtinë |
| 2001-2004 deputet i LDK-së, në 2007 kandidat për deputet | √ | √ | √ | √ | √ | Mitrovicë |
| Kandidat për këshilltar komunal në Rahovec më 2007 e 2009 | | | √ | √ | √ | Rahovec |
| Këshilltar komunal në Suharekë më 2010 | √ | √ | √ | √ | √ | Suharekë |
| Ka qenë në AAK, ka kaluar në Vetëvendosje! | √ | √ | √ | √ | | Prizren |
| Ish-ministër i financave | | | | √ | √ | Mitrovicë |
| Këshilltar komunal në Prishtinë, në mandatin 2007-2009 | √ | √ | √ | | | Prishtinë |
| Ish-këshilltar për ekonomi i Hashim Thaçit | | | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Këshilltar më 2010 në asamblenë e Suharekës | √ | √ | √ | √ | √ | Suharekë |
| Këshilltar i LDK në Kuvendin Komunal në Prishtinë, më 2010 | | | √ | √ | √ | Prishtinë |
| I afërt me PDK-në, ka bërë fushatë në fb për PDK | | | √ | √ | √ | Vushtrri |
| Ka qenë e përfshirë në aktivitete politike për iniciativen qytetare për Parteshin | | | | √ | √ | Partesh |
| Ish-kryetar i degës s PDK-s në Mitrovicë | √ | √ | √ | √ | √ | Mitrovicë |
| Deputet i Kuvendit të Kosovës 2004-2007. Kandidat për deputet më 2007 | √ | √ | √ | √ | √ | Vushtrri |
| Kandidate e partisë ORA për këshilltare komunale në Mitrovicë më 2007 | | √ | √ | √ | √ | Mitrovicë |
| Deputet nga radhët e LDK-së | | √ | √ | √ | √ | Lipjan |
| Ka qenë kandidat për deputet më 2007 | | | | | √ | Vushtrri |
| Asambleist në Prizren | √ | √ | √ | √ | √ | Prizren |
| Anëtar i këshillit drejtues të PDK-së. Ish-këshilltar i ministrit në MTPT Fatmir Limaj - 2008 | | | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Kryetar i degës së Partisë Demokratike të Kosovës për Drenas dhe anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së; | √ | √ | √ | √ | √ | Drenas |
| Aktivist i PDK. Është parë në fushata të PDK-së duke përkrahur kandidatet e PDK-së | | √ | √ | √ | √ | Vushtrri |
| Me 2014 është bërë zv.minister. Është burri i Sala Berisha Shalës - Deputete e PDK-së. | √ | √ | √ | | | Prishtinë |
| Akvisist i LDK-së. Ka qenë shef i Zyrës per Marredhenie me Publikun ne KK Prishtinë. Ka dhënë dorëheqje pasi Shpend Ahmeti ka fituar garën zgjedhore më 2013. | | √ | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Këshilltar komunal në KK Viti nga LDD | √ | √ | √ | √ | √ | Viti |
| Këshilltar i ministrës së energjisë dhe minierave, Justina Pula Shiroka | √ | √ | √ | √ | √ | Prishtinë |
| Ka qenë kryetar i Forumit Rinor të PDK-së dhe anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së | √ | √ | √ | √ | √ | Klinë |
| Ka qenë deputet i PDK-së, dhe ka qenë zv.ministër në Ministrinë e Financave | | | | √ | √ | Prishtinë |

Shtimes, nga radhët e PDK-së, pati iniciuar idenë për heqjen e regjistrave të pasurisë së zyrtarëve publik nga interneti duke u thirrur në mbrojtjen e të dhënave personale.

### SHTRIRJA E PATRONAZHIT POLITIK NË NDËRMARRJET PUBLIKE

Shtrirja e patronazhit politik është shumë prezente edhe në ndërmarrjet publike. Preportr, ka arritur të verifikojë 84 zyrtarë me fuqi vendimmarrëse të punësuar nëpër ndërmarrje publike (qendrore dhe komunale) të cilët kanë lidhje direkte me partitë politike.

Vendosja e personave partiakë në krye të bordeve të ndërmarrjeve publike ndodh për shkak të dy interesave madhore të partive politike. Së pari, kjo shërben si joshje apo shpërblim nga partia për anëtarët e saj. Së dyti, kjo shërben edhe për të afruar njerëz të tjerë në parti, pasi që partia konsiderohet nga ato "që kryejnë punë për anëtarët dhe votuesit e saj".

Nga ana tjetër, vendosja e anëtarëve të partisë në borde drejtuese të ndërmarrjeve publike i jep fuqi partive politike që të ndikojnë në këto ndërmarrje për të shtyrë politikat e tyre, duke shtrirë patronazhin politik dhe duke realizuar interesat e tyre private dhe partiake.

Ndër më e veçuara në këtë rrafsh është kompania publike më fitimprurëse në vend, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës - PTK. Kjo kompani, deri më 1 tetor 2014, është udhëhequr nga një drejtor ekzekutiv, anëtar i PDK-së, ndërsa vazhdon ta ketë si kryesues të bordit të saj mbikëqyrës po ashtu një anëtar nga PDK-ja.

Preportr, ka hulumtuar vetëm për pozitat më të larta drejtuese dhe ka gjetur se 11 nga zyrtarët e lartë që drejtojnë PTK-në kanë lidhje direkte me politikën. Prej tyre tetë (8) janë të PDK-së, një (1) i LDK-së dhe një (1) i AKR-së. Të gjithë këta drejtues të PTK-së, janë duke punuar ende.

## Shtrirja e patronazhit politik në ndërmarrjet publike:

**84 zyrtarë me fuqi vendimmarrëse e që kanë përkatësi të qartë partiake, punojnë në ndërmarrje publike:**

- 26 anëtarë të bordit;
- 25 drejtorë;
- 10 kryetarë të bordeve;
- 9 zyrtarë kryesorë financiarë;
- 7 kryeshefa;
- 2 z.v kryeshefa;
- 2 zyrtarë të prokurimit;
- 2 auditorë të brendshëm, dhe;
- 1 menaxher rajonal.

- 42 nga PDK;
- 22 nga LDK;
- 11 nga AAK;
- 4 nga AKR;
- 2 nga LDD;
- 1 nga ish-partia ORA;
- 1nga PD;
- 1 nga PSHDK.

**Prej 84 këtyre zyrtarëve të lartë me pozitë vendimmarrëse;**

**56**

janë duke punuar ende, ndërsa;

**28**

zyrtarëve tjerë iu ka mbaruar mandati, por ende nuk kanë përfunduar proceduarat e plotësimit të këtyre vendeve apo rizgjedhjen e tyre.

# Trendi i emërimeve dhe vazhdimësia e ushtrimit të funksionit nga zyrtarët e lartë publik, për të cilët, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese – Preportr, ka gjetur dëshmi se i përkasin një partie politike.

| VITET | LDK | PDK | AAK | LDD | ORA | VV | PD | AKR | Iniciativa Serbe | NISMA | PDT | PSHDK | TOTALI: |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1999** | 1 | | 1 | | | | | | | | | | 2 |
| **2000** | | | | | | | | | | | | | 0 |
| **2001** | | | | | | | | | | | | | 0 |
| **2002** | 2 | 1 | | | | | | | | | | | 3 |
| **2003** | 2 | | | 1 | | | | | | | | | 3 |
| **2004** | 1 | | 1 | | | | | | | | | | 2 |
| **2005** | 3 | 2 | 1 | 1 | | | | | | | | | 7 |
| **2006** | | 1 | | 1 | | | | | | | | | 2 |
| **2007** | 2 | 2 | | | | 1 | | | | | | | 5 |
| **2008** | 8 | 21 | 2 | 1 | 1 | | | 1 | | | | | 34 |
| **2009** | 15 | 18 | 1 | | | | | 1 | | | 1 | 1 | 37 |
| **2010** | 14 | 17 | 5 | 2 | 1 | | 1 | | | | | | 40 |
| **2011** | 10 | 21 | 5 | 1 | 1 | 1 | | 2 | | | | | 41 |
| **2012** | 6 | 26 | 5 | 1 | 2 | | 1 | 7 | | 2 | | | 50 |
| **2013** | 2 | 9 | 3 | 1 | | | 1 | 2 | 1 | | | | 19 |
| **2014** | | 2 | | | | | | | | | | | 2 |
| **Pa datë** | 2 | 1 | | | | | | | | | | | 3 |
| **Totali** | 68 | 121 | 24 | 9 | 5 | 2 | 3 | 13 | 1 | 2 | 1 | 1 | 250 |

### UNIVERSITETET E POLITIZUARA

Përkatësia partiake si duket është kusht për të marrë pozita edhe në universitetet publike. Preportr, ka arritur të verifikojë se 18 persona që kanë pozita vendimmarrëse nëpër fakultete janë të lidhur direkt me partitë politike. Ndërkaq 13 prej tyre janë duke punuar ende.

Duhet përmendur se këto janë vetëm pozita udhëheqëse në universitete publike pasi që ka një numër të konsiderueshëm të profesorëve që kanë lidhje me partitë politike duke qenë madje edhe pjesë e listave zgjedhore. Në një hulumtim të mëhershëm të Preportr, tregohet se 102 politikanë dhe zyrtarë të lartë publik janë të angazhuar si profesorë në Universitetin e Prishtinës, por edhe në kolegje private.

### SHËNDETËSIA PARTIAKE

Institucionet shëndetësore kosovare nuk kanë arritur të krijojnë imunitet ndaj patronazhit politik. Hulumtimi i Preportr, tregon se 29 zyrtarë (shumica prej tyre mjekë) që janë në pozita udhëheqëse nëpër klinika të QKUK-së, spitale rajonale etj., janë të lidhur direkt me partitë politike. Nga ky numër, 25 prej tyre ende i mbajnë këto pozita. Për dallim nga institucionet tjera në shëndetësi duket se primatin e mbanë LDK-ja për punësime partiake.

Ky fakt tregon se tendenca për kontroll të institucioneve të shëndetësisë nga ana e partive politike është e njëjtë si tek të gjitha institucionet tjera publike.

Një shtrirje kaq e gjerë e patronazhit politik që ka depërtuar në të gjithë infrastrukturën publike institucionale si dhe ka prekur pothuajse të gjitha pozitat vendimmarrëse, ka betonizuar perceptimin se punësimi, por edhe avancimi profesional në hierarkinë e institucioneve publike, mbahet peng nga vullneti i partive politike.

## Patronazhi politik i shtrirë edhe në UP

**18 persona që kanë pozita vendimmarrëse nëpër fakultete janë të lidhur direkt me partitë politike:**




7 dekanë; 7 prodekanë; 2 rektorë; 1 prorektor, dhe 1 sekretar në UPZ.

**11 prej tyre janë duke punuar ende.**

## Patronazhi politik në institucionet shëndetësore:

**29 zyrtarë që kanë lidhje me parti politike janë në pozita udhëheqëse nëpër klinika të QKUK-së dhe spitale rajonale:**




21 drejtorë; 5 kryeshefa; 1 kryetar i bordit nacional në një spital rajonal; 1 shef i Kabinetit të Diabetologjisë, dhe 1 z.v drejtoreshë.

**25 prej tyre janë duke punuar ende.**

### LIGJET LEJOJNË POLITIZIMIN E INSTITUCIONEVE

Kuadri ligjor i cili e rregullon punësimin në administratë publike, duke filluar nga sekretarët e përgjithshëm e deri tek ai që rregullon punësimin në agjenci, rregullatorë të pavarur, përfshirë ndërmarrjet publike, duket se lejon politizimin e institucioneve publike.

Ndonëse Ligji për Shërbimin Civil, neni 11, specifikon se "pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve", megjithatë ky ligj nuk ka arritur ta parandalojë politizimin e administratës publike.

Predispozitat ligjore specifikojnë që bordet duhet të jenë profesionale dhe pa precedentë penal apo interesa personale. Sidoqoftë, ligjet mbi agjencitë nuk specifikojnë asgjë mbi përkatësinë paraprake politike të këtyre drejtorëve. Si pasojë, drejtorët e këtyre agjencive të rëndësishme të pavarura mund jenë anëtarë të lartë vendimmarrës të partive politike apo edhe të përzgjedhur politik.

Kurse tek procesi i përzgjedhjes së bordeve, ligji për ndërmarrjet publike parasheh që anëtarët e këtyre bordeve të jenë të paanshëm politikisht. Më saktësisht, një kandidat të paktën 36 muaj para datës së aplikimit nuk mund të jetë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike.

CIVIL RIGHTS DEFENDERS
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC
OPEN SOCIETY INSTITUTE
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
FREE PRESS UNLIMITED
SWEDEN

**Vërejtje:** Të gjeturat në këtë hulumtim si dhe përfundimet e tij assesi nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve, por janë përgjegjësi e Organizatës për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – Çohu, në kuadër të së cilës vepron Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese.